



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:004930

Datë: 16.03.2022

Numri i dokumentit: 02820230

C.nr.100/20

Gjykata Themelore në Ferizaj, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Kreshnike Zymberi Beqiri, në çështjen juridike kontestimore të iniciuar me padinë e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë rr. "Lidhja e Pejës" p.n., kundër të paditurit S.K nga Prizreni rr. "....." nr....., me objekt kontesti rimbursim dëmi, vlera e kontestit 2,250.00€, jashtë seance më datë 16 mars 2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I.** Gjykata Themelore Në Ferizaj, SHPALLET JOKOMPETENTE në pikëpamje territoriale për procedimin e kësaj çështje juridike.
- II.** Pasi që të bëhet i formës së prerë ky aktvendim, padia i dërgohet në kompetencë Gjykatës Themelore në Prishtinë.

A r s y e t i m

Paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit ka parashtruar në këtë gjykatë me datën 16.01.2020, kundër të paditurit S.A, për çështjen rimbursim i dëmit material dhe jo material si pasojë e aksidentit të datës 16.04.2018 të ndodhur në Prishtinë.

Gjykata në shqyrtimin paraprak të padisë, ka gjetur se i padituri me adresë të vendbanimit është në qytetin e Prizrenit dhe po ashtu ka vlerësuar faktin se aksidenti i datës 16.04.2018 ka ndodhur në territorin e Komunës së Prishtinës, e që bazuar në të dyja këto fakte kjo gjykatë nuk ka kompetencë territoriale për gjykimin e kësaj çështje.

Andaj, bazuar në nenin 47 par.1 të LPK-së thuhet se: *''për gjykim të kontesteve për shpërblimin e dëmit përpos të gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, është kompetente edhe gjykata në territorin e së cilës është kryer veprimi dëmtues apo gjykata në territorin e së cilës ka lindur pasoja e dëmtimit''*, me qenë se aksidenti i datës 16.04.2018 ka ndodhur në territorin e Komunës së Prishtinës si dhe pasojat janë shkaktuar po në këtë territor, kjo gjykatë vlerëson se kompetencë territoriale për gjykimin e kësaj çështje ka Gjykata Themelore në Prishtinë.

Gjykata pasi ka vlerësuar kompetencën territoriale për vendosje në këtë çështje kontestimore duke ju referuar nenit 47 par.1 lidhur me par.3 dhe 387 par. 1 pika u) dhe lidhur me nenin 392 pika a) të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
C. nr.100/20, me datën 16 mars 2022

Gjyqtarja

Kreshnike Zymberi Beqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.